



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 748/1 prot.

Tiranë, më 22.09.2020

V E N D I M

Nr. 113, datë 22. 09. 2020

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 55, datë 17.06.2020, e shtetasit H. D., kundër Bashkisë Mat, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të gjendjes shëndetësore¹ dhe bindjeve politike²*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Mat Nr. 120, datë 01.04.2016, është emëruar në pozicionin e Inspektorit të Mjedisit, pranë Agjencisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Vadtjes, në Bashkinë Mat. Në vijim të emërimit të tij, më datë 02.11.2016, ka nënshkruar Kontratën Individuale të Punës, me punëdhënësin deri më datë 02.02.2017. Pas këtij momenti, ndërmjet ankuesit dhe Bashkisë Mat nuk ka patur më një kontratë të nënshkruar, duke konsideruar marrëdhënien e punës në vijim dhe me afat të pacaktuar.

Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019, në krye të Bashkisë Mat është zgjedhur A. G., si përfaqësues i subjektit politik “Partia Socialiste”. Me emërimin e A. G. në krye të Bashkisë Mat, ankuesi

¹ Vërtetuar me anë të Fletë drejtimi për KEMP, Nr. Rregj. 1697, datë 06.01.2020, lëshuar nga Spitali Burrel-Mat; Raport Paaftësie të Përkohshme në punë Nr. 11245, datë 19.12.2019; Nr. 0783654, datë 06.01.2020; Nr. 0783656, datë 06.01.2020; Nr. 0525054, datë 03.03.2020 etj.

² Për shkak të anëtarësimit në subjektin politik “Partia Republikane Shqiptare”, vërtetuar me anë të Vërtetimit datë 19.12.2019, lëshuar nga Partia Republikane Shqiptare, Dega Mat.

pretendon se ndaj tij ka nisur një sjellje diskriminuese për shkak të bindjeve politike të kundërta me Kryetarin. Fillimisht me anë të shkresës nr. 3255 prot., datë 09.10.2019, ankuesi është njoftuar nga ana e punëdhënësit, lidhur me fillimin e procedurave për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, duke kërkuar që brenda 3 ditëve të paraqitet për bisedime. Për periudhën 08.10.2019 deri më datë 22.10.2019, ankuesi sqaron se ka qënë me Raport Paaftësie të Përkohshme në punë. Pas përfundimit të periudhës së raportit ankuesi është paraqitur në punë dhe ka kërkuar të realizojë një takimin me strukturat e përgjegjëse të Bashkisë Mat, sa i përket diskutimit për vijimin e marrëdhënieve të punës. Me Urdhërin Nr. 713, datë 16.12.2019, Kryetari i Bashkisë Mat, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së ankuesit me motivacionin “*shkurtim i vendit të punës*” dhe është vënë në dijeni nëpërmjet shërbimit postar, më datë 19.12.2019. Për këtë periudhë, ankuesi sqaron se ka qënë me raport paaftësie në punë dhe ka njoftuar nëpërmjet shërbimit postar punëdhënësin.

Sa i përket përmbajtjes, së Urdhërit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ankuesi ngre pretendimin se në momentin që është emëruar në punë ka qënë pjesë e Agjencisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Vadijes, ndërsa në Urdhërin e sipërcituar ai është larguar nga pozicioni i Inspektorit të Mjedisit dhe Mikqyrjes së Tregut të Produkteve Blektorale pranë Njesisë së Adiministrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadijes. Pra, në këtë kuptim ankuesi pretendon se veprimet e sipërcituara nga ana e Bashkisë Mat janë kryer në mënyrë të njëanshme dhe zgjidhja e kontratës së punës ka qënë e paragjykuar. Gjithashtu, ndërprerja e marrëdhënieve të punës është bërë në kohë të papërshtatshme për shkak se ai ka qënë me raport paaftësie, për të cilin ka qënë në dijeni edhe punëdhënësi.

Gjithashtu, sipas ankuesit një tjetër veprim nga ana e Kryetarit të Bashkisë Mat është, njoftimi drejtuar atij, në cilësinë e Sekretarit të Partisë Republikane, Dega Mat, për të vendosur marrëveshje me anë të lidhjes së kontratës së përdorimit të ambjenteve-zyra të ish-Komitetit të Partisë ose lirim të tyre pasi ambjentet janë pronë e Bashkisë Mat dhe përdoren në kushte paligjshmërie.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 55, datë 17.06.2020 të H. D. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 819 prot., datë 24.06.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Mat, për ankesën e bërë nga H. D. si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të procedurës së ndjekur për largimin nga puna të H. D.
- Kopje të dosjes personale të H. D.
- Kopje e vlerësimeve të punës të subjektit ankues për tre vitet e fundit, nëse ka.
- Informacion dhe kopje të dosjeve personale (aktit të emërimit, arsimimit, eksperiencës në punë etj.), lidhur me punonjësit që mbajnë poicionin e Inspektorit të Mjedisit dhe Mbikqyrës të Tregut të Produkteve Blektorale pranë Njesisë së Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vaditjes.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Informacion nëse ka patur punonjës të tjerë të Bashkisë Mat të cilët janë larguar si pasojë e ristrukturimit të Institucionit. Nëse po, kopje të akteve të largimit të tyre nga puna.
- Kopje të strukturave organizative të Bashkisë Mat përpara dhe pas ndryshimeve të pësuar.
- Relacionin përkatës, lidhur me arsyet e ndryshimit të strukturës së Bashkisë Mat.
- Kopje të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Mat.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit lidhur me përdorimin e ambjenteve-zyra të ish-Komitetit të Partisë, nga Partia Republikane, Dega Mat.
- Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Me shkresën⁴ nr. 2516/1 prot., datë 09.07.2020, Bashkia Mat, në mes të tjerash informoi se: *“Si fillim, ju konfirmojmë që ankuesi është emëruar në pozicionin e Inspektorit të Mjedisit pranë Agjencisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Vadijtjes, me aktin nr. 120, datë 01.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Mat. Në lidhje me pretendimin, për sjellje diskriminuese të Kryetarit të Bashkisë Mat ndaj ankuesit për shkak të bindjeve të tij politike, dua t’ju bëjë me dije se është një pretendim i pabazuar në fakte konkrete, por i ngritur thjeshtë për të bërë lajm dhe për vetvlerësim politik nga ana e tij. Kjo edhe për faktin e thjeshtë, se ankuesi nuk është ndonjë person që ka një rol politik që mund të tërheqi vëmendjen, ndërsa nga ana tjetër aktualisht në Bashki vijojnë të punojnë pjesa me e madhe e stafit të mëparshëm, madje që mund të jenë njohur për bindjet e tyre politike, që po të përdorim terminologjinë e ankuesit janë te kundërta me ato të Kryetarit të Bashkisë Mat. Ndërsa, përsa i përket fillimit të procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, theksojmë se ajo ka qënë një procedurë normale në vijim të ristrukturimit të institucionit, pasi struktura e gjetur pas ndryshimit në drejtimin e Bashkisë është konsideruar jo e përshtatshme dhe për këtë arsye janë bërë disa ndryshime në mënyrë që të përmirësohet akoma më shumë përmbushja e misionit të Bashkisë, me synimin për ofrimin e shërbimeve më cilësore ndaj koniunitetit të zonës në të cilën shtrihet Bashkia Mat. Referuar nenit 64/j ‘Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë’ të Ligjit nr. 139/2015 ‘Për Vetëqeverisjen Vendore’ i ndryshuar, parashikohet ‘Miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion .. dhe të njëjsteve e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi’, kjo është një kompetencë që i njihet me ligj Kryetarit të Bashkisë për të bërë ndryshime në strukturë, me qëllim që të mundësohet një performancë më e mirë e institucionit që ai drejton. Duke ju kthyer edhe një herë procedurës së ndjekur për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, ju bëjmë me dije se është ndjekur në mënyrë korrekte çdo parashikim ligjor për rastin në fjalë dhe konkretisht dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’ i ndryshuar, neni 143, 144, 149 e vijuese të këtij Kodi, pa lënë mënjane këtu edhe parashikimet e Kontratës Individuale të Punës nr. 2888 prot., datë 02.11.2016, ku në nenin 16 ‘Zgjidhja e kontratës’ të kësaj kontrate, parashikohet si rast për zgjidhjen e saj ‘Kur mbyllet aktiviteti i*

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 636/2 prot., date 30.06.2020

institucionit apo shkurtohet vendi i punës “. Është pikërisht rasti i fundit, që është bërë shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Në respektim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, me shkresën nr. 3255 prot., datë 09.10.2019, i është dërguar njoftimi për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, shkresë për të cilën ka marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar, ku i është bërë me dije afati ligjor për të zhvilluar bashkëbisedimin me punëdhënësin. Por, megjithëse ka qënë i pranishëm gjatë gjithë kohës në mjediset e Bashkisë (madje edhe gjatë periudhës që pretendonte se ka qënë me raport paaftësie në punë) dhe ka patur kontakte me eproret direkt dhe njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, ankuesi nuk është paraqitur për bashkëbisedim dhe nuk është aspak e vërtetë se ka kërkuar të realizojë takim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë Mat. Askush nuk e ka penguar të bashkëbisedojë me strukturat përkatëse, madje i është kërkuar një gjë e tillë kur ka qënë i pranishëm në zyrën e burimeve njerëzore, por është përprjekur të bëjë lojë fjalësh dhe nuk ka pranuar të mbahet protokoll me shkrim, kjo konfirmohet edhe nga punonjëset e kësaj zyre. Ai, më së shumti ka qënë i interesuar të dijë se kur do të dilnin aktet e tjera shkresore për të rakorduar marrjen e raporteve të paaftësisë në punë, gjë që vërtetohet nga data e lëshimit të akteve në fjalë, të cilat si për habinë e të gjithëve përputhen me datat e raporteve mjekësore....Në vijim të konfirmimit të njëanshmërisë së ankuesit në perceptimin dhe gjykimin e rrethanave të çështjes është edhe fakti, se pasi ka marrë dijeni, se në zbatim të nenit 144 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07. 1995 ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’ i ndryshuar, po i dërgohej shkresa ku i bëheshin me dije arsyet dhe data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, pas shumë mundimeve është arritur të gjëndet nga punonjësit e shërbimit postar për t’i dorëzuar shkresën në fjalë, madje ka refuzuar marrjen e saj, fakt ky që konfirmon dijeninë e tij për përmbajtjen e shkresës, por edhe në kuptim të parashikimeve ligjore (përfshirë këtu nenin 155 të Kodit të Procedurave Administrative apo edhe nenin 130 të Kodit të Procedurës Civile), njoftimi quhet i kryer, pasi lajmërim marrja është nënshkruar nga punonjësi i shërbimit postar që kishte detyrën për dërgimin e shkresës, si dhe nga një punonjës tjetër si dëshmitar. Edhe në lidhje me urdhrin nr. 713, datë 16.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë Mat, ku është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënieve të punës të ankuesit me motivacionin ‘shkurtim i vendit të punës’, ju bëjmë me dije se kjo ka qënë pjesë e ecures normale të procedurës, ku kjo gjë i është bërë me dije edhe paraprakisht me shkresat e tjera, por edhe verbalisht...Gjithsesi, Bashkia Mat, duke qënë e interesuar më së shumti, si për shëndetin e punonjësve, por edhe të respektimit të dispozitave ligjore në fuqi, nuk ka vepruar me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, por i ka pezulluar urdhërit efektet e tij deri në mbarim të afatit që raporti i paaftësisë kishte parashikuar, duke i paguar pagën deri në fund të vitit. Për këtë po ju përcjellim list-prezencën e njësisë për muajin dhjetor 2019, pjesë e së cilës ka qënë ankuesi, si dhe kopjen e librezës së punës, që konfirmon ndërprerjen e marrëdhënies së punës në fund të periudhës së raportit të paaftësisë, dhe që ishte bërë shkak për ndërprerjen e afateve të aktit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Për pjesën tjetër në vijim, raportet për paaftësi të përkohshme në punë nga sëmundje të përgjithshme që paguhen nga sigurimet shoqërore, për datat në vijim të raportit të paaftësisë që paguhen nga punëdhënësi, dhe që mbajnë datën 6 janar 2020 e vujuese janë paraqitur pranë Bashkisë Mat në muajin qershor të vitit në vijim. Kështu që, edhe veprimet në bazë të nenit 21/2 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 'Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë', janë kryer në momentin e paraqitjes së raporteve, por që nuk kanë ndikim tek akti për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës pasi, Bashkia Mat në cilësinë e punëdhënësit nuk ka qënë në dijeni të këtij fakti. Nga ana tjetër angazhimi për të bërë pagesat nga sigurimet shoqërore pavarësisht mënyrës së marrjes së akteve nga institucionet e shërbimit spitalor, tregon angazhimin e titullarit të Bashkisë Mat për tju gjendur pranë të gjithëve në zgjidhjen e problemeve që kanë, përfshirë edhe ankuesin në fjalë. Nga sa më sipër, besojmë se është plotësisht e provuar se nuk kemi në asnjë moment të bëjmë me diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, por është bërë maksimumi për të respektuar gjendjen shëndetësore të ankuesit, megjithëse realiteti ka qënë krejt ndryshe, ashtu sikundër provohet edhe nga faktet e mësipërme.

Në lidhje me emërtesën e pozicionit të punës, ku në fillim emërimi ka qënë në pozicionin Inspektor Mjedisi në Agjencinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Vadtjes, ndërsa më pas në po të njëjtin pozicion pjesë e Njesisë së Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadtjes, ju sqarojmë se ndryshimi është bërë në strukturën e vitit 2018 në vijim të rekomandimeve të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil nr. 89 prot., datë 22.01.2018 'Në vëmendjen tuaj në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, 'Për nëpunësin civil', i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucionit për vitin 2018', ku rekomandohej që në zbatim të ligjit nr. 90/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore' nuk duhej të përdorej emërtesa 'agjenci', por të trajtohen si funksione sektori, etj. Për këtë arsye, në aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës është përdorur emërtesa si njësi, ndërsa në nenin 6 të Kontratës Individuale të Punës nr. 2888 prot., datë 02.11.2016, parashikohet 'Gjatë zbatimit të kontratës, punëdhënësi mund të transferojë punëmarrësin në vende pune ose detyra të tjera brenda Bashkisë Mat dhe institucioneve të tjera të varësisë. Paga që do të përfitojë në keto raste do të jetë sipas vendit të ri të punës, në përputhje me tabelën e pagave të miratuar nga Këshilli Bashkiak.'. Kjo nënkupton që pavarësisht ndryshimit të emërtesës së agjencisë në "njësi", pozicioni i punës ka qënë i njëjtë dhe trajtimi financiar ka qënë po i njëjtë sipas vendimit të këshillit bashkiak respektiv. Në këtë mënyrë, nuk mendojmë se në këtë rast ka patur elementë paragjykimi apo diskriminimi në trajtimin e ankuesit, përderisa janë respektuar me korrektësi dispozitat ligjore dhe ato të akteve nënligjore në fuqi, përfshirë edhe ato të kontratës së punës. Kjo edhe për faktin se e njëjta procedurë është zbatuar për të gjithë punonjësit e kësaj njësie, ku janë ndërmarrë hapat për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për të gjithë stafin e njësisë, fakt ky që vërtetohet lehtësisht edhe në formë shkresore. Ndërsa në lidhje me pretendimin e përseritur të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në kohë të papërshtatshme, jua konfirmojmë edhe një herë në vijimësi të

sqarimeve të mësipërme se kjo nuk është aspak e vërtetë pasi punonjësi në fjalë është paguar edhe gjatë kohës që ka patur raport paaftësie, fakt ky që rikonfirmohet edhe nga list-prezenca e muajit dhjetor 2019 për njësinë ku ankuesi ka qënë në marrëdhënie pune.”.

Sa i përket njoftimit të Bashkisë Mat, drejtuar ankuesit në cilësinë e Sekretarit të Partisë Republikane, Dega Mat, u sqarua ndër të tjera se: “...Edhe në këtë rast, ankuesi e ka një pretendim fiktiv, të ngritur jo të bazuar në fakte, por në ide që po të thuash shumë fjalë diçka do të mbetet. Procedura e nisur në këtë rast është e bazuar në kompetencat që ligji në fuqi, konkretisht të ligjit nr. 139/2015 ‘Për Vetëqeverisjen Vendore’ i ndryshuar, i cili në pikën 1.6, germa “a”, të nenit 9 parashikohet ‘a) të drejtën e lidhjes së kontratës’, ndërsa po këtu parashikohet, pika ‘1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës: a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave;’, po këtu pika 1.2. ‘Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë: a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejtat të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;’, si dhe duke shtuar këtu edhe parashikimet e Kodit Civil për këto raste, për të cilat për shkak të njohjes së gjërë që ekziston për këto institute të së drejtës, nuk po ndalemi nen për nen, Bashkia Mat ka nisur një proces për njohjen e pronave të saj (prona publike) dhe për mundësinë që në përputhje me paketën fiskale të mundësojnë vjeljen e të ardhurave, të cilat do të përdoren për realizimin e misionit të saj për të ofruar shërbime dhe investime, të cilat do të bëjnë më të mirë jetën e komunitetit në tërësi, pa anashkaluar edhe interesat e individëve të veçantë, por mendojmë se interesi i përbashkët prevalon mbi atë të individit.

Në gjithë analizën e paragrafit të mësipërm, vërtetohet se nuk kemi të bëjmë me asnjë element diskriminimi me karakter bindjesh politike, por është ky subjekt që përdor ambientet publike në kundërshtim me ligjin, pa asnjë marrëveshje paraprake me pronarin legjitim të këtyre mjediseve, Bashkinë Mat.”

Në përfundim, Bashkia Mat, hedh poshtë pretendimet e subjektit ankues për diskriminimin e tij për shkak të gjendjes shëndetësore apo bindjeve politike.

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar Bashkia Mat, vuri në dispozicion të KMD-së, një pjesë të informacionit të kërkuar, si më poshtë vijon:

- Kopje të procedurës së ndjekur për largimin nga puna të H. D.
- Kopje të dosjes personale të H. D.
- Informacion nëse ka patur punonjës të tjerë të Bashkisë Mat të cilët janë larguar si pasojë e ristrukturimit të Institucionit. Kopje të akteve të largimit të tyre nga puna.
- Kopje të strukturave organizative të Bashkisë Mat përpara dhe pas ndryshimeve të pësuar.
- Kopje të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Mat.

- Informacion dhe kopje të dokumentacionit lidhur me përdorimin e ambjenteve-zyra të ish-Komitetit të Partisë, nga Partia Republikane, Dega Mat.
- Në vijim për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së H. D. dhe në mungesë të informacionit të plotë, Komisioneri me anë të e-maileve datë 28.08.2020 dhe 31.08.2020 kërkoi nga ana e Bashkisë Mat, shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Përshkrimin e pozicionit të punës Specialist Bujqësie dhe Mjedisi;
 - Përshkrimin e pozicionit të punës Specialist i Pyjeve;
 - Pozicionet e sipërcituara, a kanë qënë pozicione me status nëpunësi civil? Si janë bërë më parë emërimet në këto pozicione?
 - Ndryshimi i Strukturës, a i ka prekur punonjësit që kanë qënë më parë Inspektor Pyjor dhe Inspektor Mjedisi?
 - A ka persona që janë emëruar rishtas, nga Inspektorët Pyjor dhe Inspektorët e Mjedisit, të cilët janë larguar më parë me ndryshimin e strukturës?
 - A ka nisur procesi i plotësimit të pozicioneve Specialist Bujqësie dhe Mjedisi, dhe Specialist i Pyjeve?

Me anë të e-mailit datë 02.09.2020, sa i përket pozicione të punës Specialist Bujqësie dhe Mjedisi dhe Specialist i Pyjeve, Bashkia Mat informoi ndër të tjera se: *“Me strukturën aktuale këto pozicione janë të parashikuara si pjesë e shërbimit civil, ndërsa në strukturën e mëparshme këto pozicione pune nuk kanë qënë pjesë e shërbimit civil (janë trajtuar sipas parashikimeve të Kodit të Punës, sikundër vërtetohet edhe nga kontrata e punës e ankuesit, por edhe e të gjithë stafit të njësisë), pasi kanë qënë të përfshira në Njësinë e Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadijtjes (në fillim ka patur emërtesën Agjencia e Bujqësisë, Pyjeve dhe Vadijtjes), njësi kjo që nuk ka qënë pjesë e administratës qendrore të Bashkisë Mat, por strukturë e varur nga ish-Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Pyjeve”.*

Sa i përket pyetjes nëse ndryshimi i strukturës i ka prekur të gjithë punonjësit e Njësisë së Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadijtjes, përfshirë këtu edhe pozicionet e Inspektorit Pyjor dhe Inspektorit të Mjedisit, Bashkia Mat konfirmojë se: *“...për të gjithë punonjësit e njësisë në fjalë është kryer procedura e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës...”*.

Lidhur me pyetjen nëse ka persona që janë emëruar rishtas, nga Inspektorët Pyjor dhe Inspektorët e Mjedisit, të cilët janë larguar më parë me ndryshimin e strukturës, Bashkia Mat sqaroi: *“Pjesa më e madhe e tyre janë rekrutuar rishtazi, në përputhje me ndryshimet strukturore të bërë rishtazi, por duke patur parasysh misionin dhe detyrat funksionale të Sektorit të Pyjeve dhe Veterinarisë. Gjithashtu, është marrë në konsideratë edhe arsimi i secilit punonjës, në mënyrë që të përputhet niveli arsimor dhe lloji i diplomës me pozicionet e punës. Në rastin e H. D.,*

ai është i diplomuar në “Ekonomi agrare” dhe për këtë llojë diplome nuk ka patur hapësirë për rekrutim në ndonjë nga pozicionet e krijuara rishtazi, si dhe nga ana tjetër nuk ka qenë punonjës me status të nëpunësit civil e për rrjedhojë nuk ka qenë detyrim ligjor ofrimi i ndonjë pozicioni pune të së njëjtës kategori.

Theksojmë se, pozicioni i punës së “Inspektorit të mjedisit” nuk është parashkuar në strukurën e re si pozicion pune më vete, por i është bashkëngjitur si detyrë shtesë Specialistit të Bujqësisë dhe për këtë arsye edhe emërtesa e pozicionit në strukturën e re quhet “Specialist i Bujqësisë dhe Mjedisit”. Punonjësi i emëruar në këtë pozicion është një ish-punonjës i Bashkisë Mat, pjesë e ish- Njesisë së Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadijës, si dhe ka përfunduar Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit pranë Universitet Bujqësor të Tiranës, dhe sikundër shihet profili i tij arsimor është më afër pozicionit të Specialist të Bujqësisë dhe Mjedisit sesa ai i H. D.. Konkretisht, nga ish-punonjësit e Njesisë së Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadijës, janë rimarrë në punë: P. Rr.- Specialist Veteriner, D. D.- Specialist Veteriner, S. L.- Specialist Veteriner, I. Ll.- Specialist Veteriner, E. B.- Specialist i Bujqësisë dhe Mjedisit, N. K.- Specialist i Pyjeve, E. A.- Specialiste e Pyjeve, I. K.-Specialist i Pyjeve, Ll. Ll.-Punonjës i Pyjeve, B. P.- Punonjës i Pyjeve, R. K.- Punonjës i Pyjeve, Xh. H.-Specialiste Kullimit dhe Vadijës, M. K.-Ekonomist, të gjithë këta kanë qenë punonjës të njësisë dhe janë rekrutuar rishtazi në përputhje me strukturën e re.”

Në përfundim të përgjigjes, Bashkia Mat sqaroi se: “... e përsërisim sërish se në stafin aktual të Bashkisë vijnë në punojnë në pozicionet e mëparshëm apo të ngjashme pjesa më e madhe e stafit të mëparshëm të Bashkisë Mat, para ndryshimit të Kryetarit të saj pas zgjedhjeve të 30 qershorit 2019. Konkretisht, janë të gjithë punonjësit që ju citova më sipër, po ashtu është i gjithë stafi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Sektorit të Tatimeve dhe Taksave Vendore, përgjegjësi i Taksës së Pronës (sektor i krijuar rishtazi, përgjegjësi është punonjësi që ka qenë përgjegjës i Sektorit të Tatimeve dhe Taksave Vendore), Sektori i Financës dhe kështu me radhë edhe në sektorët e tjerë. Natyrshëm që edhe largime ka patur, por që janë fokusuar në respektimin e kriterëve ligjore rast pas rasti, dukem ju përshtatur strukturës së re të Bashkisë dhe përmbushjes sa më mirë të misionit të saj.”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankuesit për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për largimin e tij nga puna, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe bindjes politike.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimet e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Bazuar në pretendimet e ngritura nga ana e H. D., Komisioneri u ndal në 2 momente për analizimin e tyre.

a) Ndërprerja e marrëdhënieve të punës si rezultat i ndryshimit të Strukturës Organizative.

Mbështetur në Vendimin nr. 120, datë 01.04.2016 dhe Kontratën Individuale të Punës me afat të caktuar (1 vjeçar), me nr. 2888 prot., datë 02.11.2016, H. D. është emëruar në pozicionin *Inspektor Mjedisi*, në Agjencinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Vadijes, pranë Bashkisë Mat.

Me Urdhër Nr. 157, datë 07.05.2018, në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, emërtesa e Agjencisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Vadijes ndryshoi në Njësia e Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadijes.

Referuar vërtetimit datë 19.12.2019, lëshuar nga Partia Republikane Shqiptare, evidentohet se ankuesi është Sekretar i Partisë Republikane Shqiptare, dega Mat, nga viti 1995 e deri më sot. Gjithashtu, ka qënë anëtarë i Këshillit Bashkiak në Bashkinë Burrel, për periudhën 2003-2007 dhe ka mbajtur pozicionin e Zv/Kryetarit të Këshillit Bashkiak Burrel.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Mat u zgjodh A. M., mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Pak kohë pas emërimit të A. M. në krye të Bashkisë Mat, mbështetur në nenin 64/j të Ligjit nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”* i ndryshuar, ku parashikohet një ndër kompetencat e kryetarit të bashkisë është: *“miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e*

*institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi”, me Urdhërin nr. 419, datë 25.09.2019, u miratua Struktura dhe Organika e re e Bashkisë Mat. Me miratimin e saj, disa nga pozicionet e punës u shkurtuan dhe nga 448 numri i punonjësve u reduktua në 415. Ndryshimet e pësuara në strukturë prekën edhe pozicionet e punës së Njesisë së Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadtjes, ku pjesë e së cilës ishte dhe H. D.. Numri i punonjësve të Njesisë nga 22 u reduktua në 19 dhe 1 pozicion *Inspektor Mjedisi* që ishte më parë, me strukturën e re nuk ekzistonte më.*

Më poshtë pasqyrohet si ka ndryshuar Struktura e Njesisë së Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadtjes në atë të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve:

Njësia e Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadtjes (22 pozicione pune)	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve (19 pozicione pune)
Përgjegjës – 1 pozicion	Drejtor - 1 pozicion
Ekonomist – 1 pozicion	Spektori i Bujqësisë dhe Veterinarisë - 5 pozicione
Specialist Kullim-Vadtje – 1 pozicion	Përgjegjës Spektori - 1 pozicion
Specialist Topograf – 1 pozicion	Specialist Veteriner - 3 pozicione
Manovrator – 1 pozicion	Specialist Bujqësie dhe Mjedisit - 1 pozicion
Specialist Bujqësie – 1 pozicion	Spektori i Pyjeve – 10 pozicione
Specialist i Kontrollit dhe Mbikëqyrjes së Tregut të Produkteve Blektorale – 1 pozicion	Përgjegjës Spektori – 1 pozicion
Përgjegjës i Spektorit të Pyjeve – 1 pozicion	Specialist i Pyjeve – 8 pozicione
Inspektor Pyjor - 8 pozicione	Specialist Topograf – 1 pozicion
Inspektor Mjedisi – 1 pozicion	Spektori i Vadtjes dhe Kullimit – 3 pozicione
Përgjegjës i Spektorit të Veterinarisë – 1 pozicion	Përgjegjës Spektori – 1 pozicion
Specialist Veteriner – 4 pozicione	Specialist i Kullimit dhe Vadtjes – 1 pozicion
	Manovrator – 1 pozicion

Përpara ndryshimeve të pësuara, pozicionet e punës së Njesisë së Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadtjes, rregulloheshin me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07. 1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar. Me ndryshimin e Strukturës, Njësia e Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadtjes u shkri dhe u formua Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve. Në drejtorinë e sapoformuar evidentohet se pozicioni *Inspektor Mjedisi*

nuk ekzistonte dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës tashmë do të bëhej mbështetur në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Mat, u nis procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për të gjithë punonjësit që prekeshin nga ndryshimi i Strukturës. Në këtë kuptim, gjatë muajit Shtator 2019, u njoftuan edhe punonjësit që bënë pjesë në Njësine e Administrimit të Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Vadijes, si më poshtë vijon:

- Me shkresën nr. 3255 prot., datë 09.10.2019, u njoftua H. D., i cili mbante pozicionin *Inspektor Mjedi*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3242 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi Y. GJ., i cili mbante pozicionin *Specialist Veteriner*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3254 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi B. P., i cili mbante pozicionin *Punonjës i Pyjeve*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3247 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi S. LL., i cili mbante pozicionin *Inspektor Pyjor*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3251 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi B. S., i cili mbante pozicionin *Inspektor Pyjor*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3248 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi B. D., i cili mbante pozicionin *Inspektor Pyjor*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3256 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi I. K., i cili mbante pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3252 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi E. D., i cili mbante pozicionin *Inspektor Pyjor*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3257 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi J. F., i cili mbante pozicionin *Specialist i Kontrollit dhe Mbikqyrjes së Tregut të Produkteve Blegtorale*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3245 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi D. D., i cili mbante pozicionin *Specialist Veteriner*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

- Me shkresën nr. 3243 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi P. RR., i cili mbante pozicionin *Specialist Veteriner*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3249 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi R. K., i cili mbante pozicionin *Punonjës i Pyjeve*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3262 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi N. K., i cili mbante pozicionin *Inspektor Pyjor*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3250 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi LL. LL., i cili mbante pozicionin *Punonjës i Pyjeve*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3244 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi S. L., i cili mbante pozicionin *Specialist Veteriner*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3260 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi XH. H., e cila mbante pozicionin *Specialiste e Kullimit dhe Vaditjes*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3246 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi I. LL., i cili mbante pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të Veterinarisë*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3259 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi E. B., i cili mbante pozicionin *Specialist i Bujqësisë*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3253 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi I. K., i cili mbante pozicionin *Inspektor Pyjor*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3261 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi M. K., i cili mbante pozicionin *Ekonomist*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.
- Me shkresën nr. 3258 prot., datë 09.10.2019, u njoftua shtetasi E. H., i cili mbante pozicionin *Specialist Topograf*, për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

Gjithashtu, referuar informacionit të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Mat, me ndryshimet e pësuar në Strukturë, janë përcaktuar përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë Specialistët e Pyjeve dhe ata të Bujqësisë dhe Mjedisit. Në rastin konkret, kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë Specialistët e Pyjeve dhe ata të Bujqësisë dhe Mjedisit, janë si më poshtë:

- **Specialistët e Pyjeve:**

Arsimi: Bachelor, Master Profesional ose Master Shkencor në fushën e Ing. Pyjore apo shkollim të barazvlefshën me ta.

Përvoja: Preferohet të ketë eksperiencë pune të mëparshme në profesion.

- **Specialistët e Bujqësisë dhe Mjedisit:**

Arsimi: Të zotërojë Diplomë Universitare të nivelit Bachelor, Master Profesional ose Master Shkencor në fushën e Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë.

Përvoja: Të ketë eksperiencë pune të mëparshme në profesion.

Përsa më sipër dhe mbështetur në informacionin e administruar, rezulton se një pjesë e punonjësve, gjithësej 11, të cilët janë njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës si rezultat i shkurtimit të pozicioneve të punës dhe ndryshimit të strukturës, janë rimarrë në punë me kontratë të përkohshme deri në shpalljen e procedurave të konkurimit për plotësimin e vendeve vakante të shërbimit civil. Punonjësit e mësipërm të cilët janë marrë në pozicionet e punës, kanë plotësuar edhe kriteret për emërimin në këto pozicione pune, si më poshtë vijon:

- Shtetasi E. B., i cili më parë në Strukturën e vjetër, mbante pozicionin *Specialist i Bujqësisë*, është emëruar në pozicionin *Specialist i Bujqësisë dhe Mjedisit*, me arsim të lartë në Inxhinieri Agrare, profili Zooteknik dhe Biznes Blegtoral, *Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit*, Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- Shtetasi N. K., i cili mbante pozicionin *Inspektor Pyjor*, është emëruar në pozicionin *Specialist i Pyjeve*, me arsim të lartë me titull Inxhinier Pyjesh, në degën Mbarështim Shfrytëzim Pyjesh, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- Shtetasi I. K., i cili mbante pozicionin *Inspektor Pyjor*, është emëruar në pozicionin *Specialist i Pyjeve*, me arsim të lartë me titull Inxhinier Pyjesh, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- Shtetasi S. L., i cili mbante pozicionin *Specialist Veteriner*, është emëruar në pozicionin *Specialist Veteriner*, me arsim të lartë me titull Mjek Veteriner i Lartë, Fakulteti Veterinari, Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- Shtetasi I. LL., i cili mbante pozicionin *Specialist Veteriner*, është emëruar në pozicionin *Specialist Veteriner*, me arsim të lartë me titull Mjek Veteriner, Fakulteti Veterinari, Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- Shtetasi P. R., i cili mbante pozicionin *Specialist Veteriner*, është emëruar në pozicionin *Specialist Veteriner*, me arsim të lartë me titull Mjek Veteriner i Lartë, Fakulteti Veterinari, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

- Shtetasi D. D., i cili mbante pozicionin *Specialist Veteriner*, është emëruar në pozicionin *Specialist Veteriner*, me arsim të lartë Mjekësi Veterinare, Fakulteti Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Përsa më sipër, evidentohet se punonjësit që kanë mbajtur më parë pozicionet e *Inspektor i Pyjeve*, janë rimarrë në punë në pozicionin *Specialist i Pyjeve*, mbështetur në kërkesat e pozicionit të punës, deri në momentin e shpalljes së vendeve vakante. Ndërsa, përsa i përket pozicionit *Inspektor Mjedisit* (që ka mbajtur më parë ankuesi) dhe pozicionit *Specialist Bujqësisë* evidentohet se janë shkrirë në një pozicion të vetëm pune, në atë të *Specialistit të Bujqësisë dhe Mjedisit*.

Mbështetur në dokumentacionin e administruar, ankuesi gjatë viteve 1983-1987 ka përfunduar arsimin e lartë në Institutin e Lartë Bujqësor të Tiranës, në Ekonomi Agrare dhe i është dhënë titulli Ekonomist Plani i Lartë. Ndërsa, punonjësi i emëruar në pozicionin e *Specialistit të Bujqësisë dhe Mjedisit*, shtetasi E. B., i cili më parë në Strukturën e vjetër, mbante pozicionin *Specialist i Bujqësisë*, është emëruar në pozicionin *Specialist i Bujqësisë dhe Mjedisit*, me arsim të lartë në Inxhinieri Agrare, profili Zooteknik dhe Biznes Blegtoral, *Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit*, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Në analizë të informacionit të sipërcituar dhe referuar ndryshimeve të pësuar në Strukturën e Bashkisë Mat dhe të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve, arsimi i shtetasit E. B., emëruar në pozicionin e *Specialist i Bujqësisë dhe Mjedisit*, ishte më i përafërt me kërkesat e këtij pozicioni pune. Gjithashtu, nga kqyrja e shpalljeve për vendet e lira të punës, të bëra publike në faqen web të Bashkisë Mat, rezulton të jenë bërë vetëm për një pjesë të pozicioneve të Bashkisë Mat, kryesisht pozicionet e larta drejtuese, ndërsa pozicionet e specialistëve nuk janë bërë ende shpalljet për pozicionet e lira.

Në analizë të veprimeve të sipërcituara dhe në zbatim të implementimit të Strukturës së re Organizative të Bashkisë Mat, evidentohet se është ndjekur e njëjta procedurë për të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve. Pra, në këtë rast konstatohet se ankuesi është në të njëjtat kushte me punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve, të cilët janë nënshkruar procedurës së ristrukturimit të Bashkisë Mat dhe shkurtimit të pozicioneve të punës. Ndërsa, përsa i përket faktit që ankuesi nuk është rimarrë në një nga pozicionet e lira të punës, krahasuar me punonjësit e tjerë, u evidentua se kriteri arsimor i tyre ishte më i përafërt dhe përputhej me kërkesat e pozicionit të punës.

Përsa më sipër, Komisioneri konstaton se ankuesi nuk është vendosur në kushte të pabarabarta apo trajtuar në mënyrë të pafavorshme, në raport me punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve, sa i përket procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe emërimit pas ndryshimeve të Strukturës Organizative të Bashkisë Mat.

Mbështetur në kërkesë padinë datë 20.05.2020, të paraqitur nga palët, me objekt procedurat e ndjekura sa i përket zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, është një proces që do të trajtohet nga organet gjyqësore dhe jo nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

b) Njoftimi i bërë nga ana e Bashkisë Mat, drejtuar ankuesit në cilësinë e Sekretarit të Partisë Republikane, Dega Mat

Në analizë të provave dhe informacionit të administruar, me VKM Nr. 771, datë 14.11.2007 *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Burrel, të Qarkut të Dibrës”*, Bashkia Mat, në muajin Janar 2020, ka nisur procedurën për njoftimin e të gjithë subjekteve që kanë në përdorim pronat e saj.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”* i ndryshuar, i cili në nenin 9, pika 1.2., parashikon: *“Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë: a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejtat tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;”*, Bashkia Mat ka kërkuar nga ana e subjekteve të cilët kishin në përdorim pronat e saj, të paraqiten pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave për të arritur një marrëveshje.

Referuar shkresave të vëna në dispozicion, përdoruesit e këtyre pronave janë njoftuar që brenda një afati të caktuar të paraqiten pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave për të vendosur marrëveshje me anë të lidhjes së kontratës së përdorimit të ambjenteve-zyra tek Ish-Komiteti i Partisë; ose lirim të tyre pasi ambjentet janë pronë e Bashkisë Mat dhe po përdoren në kushtet e paligjshmërisë.

Në këtë kuptim, Bashkia Mat ka njoftuar gjithsej 9 subjekte, përfshirë dhe ankuesin, të cilët kishin në përdorim zyrat pronë e Bashkisë Mat. Nga informacioni i administruar, këto subjekte ishin kryesisht parti politike, sindikata të ndryshme, persona fizik dhe organizata ndërkombëtare.

Përsa më sipër, Komisioneri evidenton se i njëjti njoftim i është bërë të gjitha subjekteve pa marrë parasysh, bindjet politike të tyre apo faktin e të qenit subjekte politike. Në analizë të informacionit të sipërcituar, ky njoftim është bërë në të njëjtën kohë dhe me të njëjtën përmbajtje për të gjithë përdoruesit e pronave të Bashkisë Mat.

Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se nuk kemi të bëjmë me një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues nga ana e Bashkisë Mat.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit H. D. nga ana e Bashkisë Mat për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindja politike)

(Fusha: Punësim)